



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1440, datë 04.11.2010

**“Për
ankimin e operatorit Vraniger Communications shpk, mbi shlyerjen e detyrimeve
financiare per vitet 2009-2010”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen | Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku në mbledhjen e datës 04.11.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Mbi Ankimin nr. 2224 prot, date 10.05.2010 nr. 2224/1 prot, date 04.10.2010 te sipermarresit “Vraniger Communications” sh.p.k ne lidhje me detyrimet financiare per vitet 2009- 2010.*

BAZA LIGJORE :

- Nenet 76, 78 dhe 119 te ligjit 9918 date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, **Ligji nr. 9918**;
- Pikën 4 të nenit 62 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
- Neni 11 i Ligjit 9975, date 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”;
- Udhëzimi Nr. 28 datë 06.10.2008, “Për përcaktimin e tarifës se shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.28/1, date 13.11.2008, të Ministrisë se Financave dhe AKEP;
- VKM Nr.75, date 06.02.2003 “Për miratimin e pagesave qe kryhen ne ERT”
- Neni 140 dhe neni 146 i Ligjit 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- Vendimi Nr. 601 date 26.12.2008 “ Për transpozimin e Licenses se Klasit II Nr. 218/0101 date 04.01.2001, te subjektit Vraniger Communications shpk“;

- Vendimi Nr. 1090, date 18.12.2009 “Për saktësim ne VKD Nr. 601 date 26.12.2008 për sipërmarrësin “Vraniger Communications” sh.p.k, duke saktësuar aneksin nr.1 te Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave ne 15 lidhje fikse radio”;
- Rregullore për Autorizimin Individual (**Rregullorja**), miratuar me VKD nr. 510, datë 04.11. 2008;
- Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendshme të AKEP-it (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me VKD të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

Nga pikepamja formale procedurale, dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 10/1 të Rregullorës së Brendshme.

I.

- Sipërmarrësi “Vraniger Communications” sh.p.k është i regjistruar ne regjistrin e sipërmarrësve qe ofrojnë rrjete dhe shërbime te komunikimeve elektronike dhe ne regjistër mban nr. rendor 30.
- Me Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP me Nr. 601, date 26.12.2008 ka miratuar “*Transpozimin e Licenses se Klasit II Nr. 218/0101 date 04.01.2001, te subjektit Vraniger Communications shpk*” dhe ne Aneksin 1 te këtij vendimi i janë përcaktuar frekuencat për 15 lidhje fikse radio njëlloj siç kane qene ne Liçencën Nr. 218/0101.
- Bazuar ne piken 4 te Vendimit te AKEP Nr. 601, date 26.12.2008, kërkohej përditësimi i te dhënave lidhur me frekuencat qe ka ne përdorim, sipërmarrësi “Vraniger Communications” sh.p.k.
- Me shkresën Nr. 2060 prot. date 08.05.2009 ka paraqitur formularet e plotësuar me te dhënat teknike e frekuencave sipas kërkesave te rregullores se Autorizimit Individual për caktimin dhe përdorimin e frekuencave.
- Për efekt te kryerjes se llogaritjeve te detyrimeve financiare Drejtoria e Rregullimit Teknik me shkresen nr. 2290 prot, date 26.05.2009 dergon te dhenat teknike te frekuencave qe ka ne përdorim ky sipërmarrës ne 15 lidhjet fikse. Mbi bazen e kesaj shkrese jane kryer llogaritjet përkatëse sipas Udhëzimit Nr. 28, te ndryshuar dhe VKM 75 dhe sipermarresit i jane derguar faturat, respektivisht:
 - a. me shkresën e AKEP Nr. 2457, date 11.06.2009 i eshte dërguar fatura me nr. Serial 24130340, date 08.06.2009 me detyrimet financiare për tarifën e shërbimit te shërbimeve te telekomunikacioneve për vitin 2009 për përdorim te frekuencave ne 15 lidhje fikse.
 - b. me shkresën e AKEP me Nr. 2919, date 29.07.2009 i është dërguar fatura me nr. Serial 24130688, date 27.07.2009 me detyrimet financiare për pagesat për caktim dhe përdorim frekuencave ne 15 lidhje fikse, pagesa për AKEP.
- Me shkresën Nr. 3503 prot, date 08.09.2009, sipërmarrësi “Vraniger Communications” sh.p.k kerkon sqarime lidhur me faturat e derguara nga AKEP si

dhe sqaron se ne shtator 2005 ka kërkuar te hiqet komuna Drenove nga zonat e mbulimit ndërkohë qe vazhdohet te faturohet nga AKEP. Gjithashtu thekson se ky sipërmarrës aktualisht ka ne pune 6 lidhje fikse përkatësisht :

1. AT Korce – Pojan
 2. Pojan – Sheqeras
 3. Pojan – Vashtemi
 4. Pojan – Zvirin
 5. Sheqeras – Podgori
 6. Korce – Korca I
- Me kete shkrese, “Vraniger Communications” sh.p.k kerkon qe detyrimet financiare te jene vetem per lidhjet fikse qe jane aktualisht ne pune, ndersa per lidhjet e tjera do te njoftoje AKEP ne momentin e venies ne pune.
 - Me shkresën nr. 3503/1 prot, date 23.09.2009, AKEP sqaron këtë sipërmarrës si më poshtë:
 1. Me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 601 datë 26.12.2008, sipërmarresit Vraniger Communications sh.p.k i është transpozuar Liçensa e Klasit II Nr. 218/0101 datë 04.01.2001 dhe eshte pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave siç përshkruhet në Aneksin 1 bashkëlidhur vendimit (15 lidhje fikse), me afat deri më 04.01.2011. Frekuencat për lidhjet fikse në VKD Nr. 601 janë të njëjtat me ato te përcaktuara ne Liçensën Nr. 218.
 2. Me shkresën Nr. 2060 Prot. datë 08.05.2009 sipërmarresi Vraniger Communications shpk ka depozituar në AKEP të dhëna të përditësuara për frekuencat për 15 lidhjet fikse të caktuara sipas VKD Nr. 610, date 26.12.2008.
 3. Lidhur me komunën Drenovë, meqenëse Liçensa Nr. 218 është shfuqizuar në datën 26.12.2008, AKEP nuk ka derguar asnjë detyrim financiar as për komunën Drenovë dhe as për ish zonat e tjera të licensimit. Faturat Nr. 24130340 dhe Nr. 24130688 kanë të bëjnë vetëm me detyrimet financiare për tarifën e shërbimit sipas Udhëzimit Nr. 28 datë 06.10.2008 të Ministrisë së Financave dhe AKEP, i ndryshuar dhe VKM Nr. 75 datë 06.02.2003.
 - Me Vendimin e AKEP nr. 1090, date 18.12.2009 “Për saktësimin ne VKD Nr. 601 date 26.12.2008 për sipërmarrësin “Vraniger Communications” sh.p.k, duke saktësuar aneksin nr.1 te autorizimit individual për përdorimin e frekuencave ne 15 lidhje fikse radio”, sipërmarrësit i është saktësuar aneksi nr.1 i autorizimit individual për 15 lidhjet fikse radio.
 - AKEP per pagesat per caktim dhe përdorim frekuencash, bazuar ne dispozitat e neneve 78, 119 Ligji 9918, date 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike ne Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr.75, date 06.02.2003 “Për miratimin e pagesave qe kryhen ne ERT”, ka bere llogaritjet per sipërmarrësin Vraniger Communication sh.p.k, për frekuencat qe ka ne përdorim sipas Vendimit te AKEP Nr. 601, date 26.12.2008, saktësuar me Vendimin Nr. 1090, date 18.12.2009, autorizimit individual për përdorimin e frekuencave ne 15 lidhje fikse radio”.
 - Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për sipërmarrësin “Vraniger Communications” sh.p.k ka përcaktuar detyrimet financiare për tarifën e shërbimit te radiokomunikacionit, per vitin 2009 dhe 2010 bazuar në :
 - pikën 4 të nenit 62 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”
 - nenit 11 të Ligjit 9975, date 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”,
 - Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe AKEP-it Nr.28 datë 06.10.2008, “Për përcaktimin e tarifës se shërbimit për shërbimet e

radiokomunikacionit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.28/1, date 13.11.2008, të Ministrisë së Financave dhe AKEP (fletorja zyrtare nr. 157 date 14.10.2008 dhe nr. 157/1 date 13.11.2008),

- Vendimin e AKEP Nr. 601, date 26.12.2008, saktësuar me Vendimin Nr. 1090, date 18.12.2009, autorizimit individual për përdorimin e frekuencave ne 15 lidhje fikse radio”.
- Shkresën Nr. 2060 Prot. datë 08.05.2009 të sipermarresit Vraniger Communications shpk me të cilën ka depozituar në AKEP të dhënat e përditësuara për frekuencat ne 15 lidhjet fikse të caktuara sipas VKD Nr. 610, date 26.12.2008.
- Pretendimi i sipërmarrësit “Vraniger Communications” sh.p.k se nuk është njoftuar mbi detyrimet financiare shtese qe duhet te paguante pas modifikimit qe iu be licencës se tij nr. 218/0101 me date 05.08.2008 (modifikim i cili konsistonte ne zgjerimin e rrjetin te tij me 3 komuna dhe një bashki) nuk është i bazuar dhe nuk qëndron pasi fakti qe ky sipërmarrës ka shlyer detyrimet financiare shtese per 3 komunat dhe bashkinë Korce, per vitin 2008, do te thote qe i ka bere mbi bazen e nje njoftimi si dhe faturës se derguar nga AKEP. Ne modifikimin e fundit qe i eshte bere licencës se ketij sipërmarrësi me date 05.08.2008 i është shtuar si zone shërbimi bashkia Korce dhe komunat Liqenas, Miras dhe Hociisht si dhe i jane përcaktuar frekuencat per gjithsej 15 lidhje fikse dhe per vitin 2008 ky sipërmarrës eshte pajisur me dy fatura. E para përmbante detyrimet financiare te vitin 2008 (per 5 komuna dhe 1 lidhje fikse me kapacitet transmetimi 4 x 2 MB/s) dhe fatuara e dyte përmbante **detyrimet shtese** per 1 bashki, 5 komuna dhe 14 lidhje fikse. Persa i takon detyrimeve financiare si rrjedhoje e procesit te transpozimit te licenses ne autorizim individual me VKD Nr. 601, date 26.12.2008 jane pikerisht detyrimet financiare per vitin 2009 te ketij sipermarresi, per te cilat gjithashtu eshte njoftuar dhe mbi bazen e njoftimit tone ky sipermarres ka shlyer detyrimet financiare per tarifen e shërbimit per 2009 dhe nuk ka shlyer detyrimet financiare për AKEP.
- Ne lidhje me pretendimin e sipermarresit Vraniger Communications sh.p.k se ka ne perdorim frekuencat vetem ne 5 lidhjet fikse dhe jo 15 lidhje fikse dhe se ato kane qene te paraqitura edhe ne projektin kur kjo kompani kerkoi modifikimin e licenses, AKEP mendon se ne shkresen nr. 3503 prot, date 08.09.2009 sipermarresi Vraniger Communications shpk ka konfirmuar se ka ne perdorim 6 lidhje fikse dhe jo 5 lidhje fikse sic thekson ne ankimin objekt shqyrtimi. Gjithashtu ne paragrafin e fundit te shkreses nr. 3503 prot, date 08.09.2009 ky sipermarres citon se do te njoftoje AKEP ne momentin e venies ne pune te frekuencave te lidhjeve te tjera fikse qe aktualisht nuk i ka ne pune. Pra ne asnje rast nuk thote se nuk do t’i kete ne perdorim keto frekuenca por thote se do t’i vendose ne pune ato dhe do te njoftoje AKEP-in ne momentin e vendosjes ne pune. Sipermarresit duhet te shlyejne detyrimet financiare per frekuencat e caktuara nga AKEP bazuar ne ligjin 9918, date 19.05.2008, deri ne momentin kur kerkojne heqjen nga perdorimi te ketyre frekuencave.

II. Me shkresën nr. 2224/1 prot. date 04.10.2010, operatori Vraniger Communications sh.p.k i eshte drejtuar Keshillit Drejtues te AKEP me nje ankim në lidhje me faturat e AKEP. Ky ankim behet ne vijim te ankimit nr. 2224 prot, date 10.05.2010.

Ne kete ankim operatori Vraniger Communications sh.p.k, njofton:

1. Që nga 15 lidhjet fikse te caktuara ne Autorizimin Individual, ka ne përdorim vetem 5 lidhje fikse si me poshte:
 - Albtelecom – Pojan

- Pojan – Vashtemi
 - Pojan – Sheqeras
 - Pojan – Zvirin
 - Sheqeras Podgori;
2. 10 lidhjet e tjera nuk jane vene asnjehere ne përdorim;
 3. Shkresa drejtuar AKEP e dates 08.09.2009, ka qene “*nje forme kerkese per shfuqizimin e 10 lidhjeve fikse qe nuk perdoren*”. Operatori Vraniger Communications sh.p.k citon “*mesa duket kjo nuk eshte kuptuar si nje kerkese per heqjen e lidhjeve fikse*”. Ky operator kërkon ti behet me dije nese AKEP ka marre vendim per lenien ne fuqi te vetem 5 lidhjeve fikse.
 4. Ne rast se AKEP nuk ka marre vendim per heqjen e 10 lidhjeve fikse, i kërkon Keshillit Drejtues marrjen e nje vendimi ku frekuencat e 10 lidhjeve fikse ti njihen te hequra qe nga data 08.09.2009.

Pikat II - 1 dhe II - 2 te mësipërme janë njoftim i përsëritur i këtij operatori. Lidhur me pikën II - 3 te mësipërme, operatori Vraniger Communications sh.p.k nuk ka paraqitur asnjëherë kërkesë për revokimin e 10 lidhjeve fikse që i përdor. Në shkresën nr. 3503 prot, date 08.09.2009 ky operator citon se do te njoftoje AKEP ne momentin e vënies ne pune te frekuencave te 10 lidhjeve te tjera fikse. Pra shkresa nr. 3503 prot, date 08.09.2009 nuk ka formën e kërkesës për heqjen e 10 lidhjeve fikse qe nuk përdoren. Kërkesa duhet te ishte paraqitur e qartë, me emërtimet e lidhjeve fikse që hiqen nga Autorizimi Individual (aneksi 1 i VKD nr. 1090, date 18.12.2009 “Për saktësimin ne VKD Nr. 601 date 26.12.2008 për sipërmarrësin “Vraniger Communications” sh.p.k”), ne përputhje me pikën 1 te nenit 8 te Rregullores për Autorizimin Individual miratuar me VKD Nr. 510 date 04.11.2008.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë se:

Ankimi i sipërmarresit Vraniger Communications sh.p.k nga ana formale mbështetet ne dispozitat e K.Pr.A, nderkohe qe forma e paraqitjes së ankimit nuk është sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative dhe nga ana materiale objekti i ankimit administrativ është i pabazuar ligjërisht si dhe bazuar në nenin 140 dhe nenin 146 te Ligjit 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedureve Administrative”; pikën 1 të nenin 114 dhe nenin 115 të ligjit nr. 9918, si dhe Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e ankimeve te sipërmarrësit “Vraniger Communications” sh.p.k nr. 2224 prot, date 10.05.2010 dhe nr. 2224/1 prot. date 04.10.2010.
2. Amendimin e aneksit 1 të VKD nr. 1090 date 18.12.2009 “Për saktësimin në VKD Nr. 601 date 26.12.2008 për sipërmarrësin “Vraniger Communications” sh.p.k”, duke shfuqizuar anekset (lidhjet fikse) 1/5, 1/7, 1/8, 1/9, 1/10, 1/11, 1/12, 1/13, 1/14 dhe 1/15.

3. Lënien në fuqi të faturave të AKEP për sipërmarrësin “Vraniger Communications” sh.p.k me Nr. Serial 24130688 date 27.07.2009 per pagesat per AKEP dhe Nr. Serial 24131628, datë 11.03.2010.

Ky vendim hyn në fuqi datën e miratimit te tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

1. Alketa MUKAVELATI

2. Benon PALOKA

3. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURÇE